



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3134/2 Prot.

Pogradec, më 15.07.2021

VENDIM

NR. 64, DATË 14. 07.2021

**“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË VENDORE PËR ZVOGËLIMIN
E RISKUT NGA FATKEQËSITË NE BASHKINË POGRADEC 2021-2024”**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 29 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; pikës 2 dhe 5 të nenit 9; nenit 11, pikave 2 dhe 6 të nenit 14; pikës “b” të nenit 27; pikave 2 dhe 3 të nenit 29; nenit 30; pikës 2 të nenit 63; të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”; Planin Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me VKM Nr.835, datë 3.12.2004, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë në Bashkinë Pogradec për periudhen 2021-2024.
2. Dokumenti “Strategja vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë në Bashkinë Pogradec”, i bashkengjitet këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë Pogradec.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

MIRATOHET

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Z. SOTIRAQ MANGËRI

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. ___, Datë ___. 2021

STRATEGJIA VENDORE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË

BASHKIA POGRADEC

Qershor 2021




I. HYRJE	3
II. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E PLANIT LOKAL TË ZVOGËLIMIT TË RISKUT TË FATKEQËSIVE	4
III. KUADRI INSTITUCIONAL	5
IV. BASHKIA POGRADEC	7
1. Pozicioni gjeografik	7
2. Demografia dhe zhvillimi ekonomik	9
3. Turizmi	11
4. Profili i njësive Administrative	13
5. Shendetësia	18
6. Zhvillimi urban dhe infrastruktura rrugore	20
7. Mjedisi dhe përdorimi i tokës.	24
V. RREZIQET DHE RISKU I FATKEQËSIVE NATYRORE	26
1. Rreziku Sizmik	26
2. Gjoerreziqet	27
3. Rreziku nga Bora	28
4. Rreziku nga Përmbytjet	28
5. Rreziku nga Zjarret	29
6. Konkluzione mbi rreziqet	29
7. Rreziqet aktive te evidentuara në territorin e Bashkisë Pogradec	30
VI. REDUKTIMI I RISKUT NGA FATKEQËSITË PËRMES POLITIKAVE E INSTRUMENTEVE SEKTORIALE	34
1. Objektivat kryesorë:	35
2. Analiza e pikave të forta,dobësive,rreziqeve dhe mundësive	35
3. Konkluzione mbi Sfidat në Përballimin e Riskut ndaj fatkeqësive	37
4. Punë në proces	37
5. Plani vjetor 2021	38



I. HYRJE

Kuadri ligjor për "Vetëqeverisjen Vendore" nr. 139/2015 dhe Ligji Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" përakton kriteret dhe detyrimet për institucionet qendrore dhe vendore në lidhje me identifikimin e rrezikut, planifikimin e masave lehtësuese dhe investimet parandaluese, si dhe hartimin dhe përditësimin e planit të emergjencave civile në nivelin vendor dhe kombëtar. Gjithashtu, legjislationi parashikon që bashkitë të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve vendas dhe të jepin informacione publike në situatën e një fatkeqësie natyrore ose situate tjetër emergjencë. Përvojat e dekadave të fundit në menaxhimin e situatave të emergjencës civile dhe ndikimin ekonomik dhe shoqëror për shkak të humbjeve dhe dëmtimeve të pronave publike dhe private si rezultat i katastrofave natyrore kryesisht për shkak të tërmecave, zjarreve dhe përbmbytjeve kanë identifikuar mangësi në sistemin e mbrojtjes civile, mungesa të kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore, profesionale dhe teknike për të parandaluar situatat dhe minimizuar dëmet në raste fatkeqësish. "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë" është dokument i rëndësishëm i hartuar në mbështetje të ligjit Nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile" dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me emergjencat civile.



"Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë", duhet të shihet si dokument praktik, i hartuar nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur me ndryshimet e mjesdit, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar: mbrojtjen e popullsisë, të pronës dhe të trashëgimisë

kulturore nga emergjencat civile. Në kushtet kur ekziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje dhe përmirësim dhe ku burimet janë të kufizuara, planifikimi i përdorimit të kapaciteteve, ndarja mirë e përgjegjësive, identifikimi i boshllëqeve dhe shëmangia e mbivendosjeve është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa bëhen realitet nëpërmjet kësaj strategjie, që ofron mundësi për menaxhim efektiv të strukturave vendore dhe qëndrore për përballimin e emergjencave civile. Bashkia Pogradec është mjaft e eksposuar përballë një numri të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tifet, por kohët e fundit kanë qenë mjaft evidente përbmbytjet, rrëshqitjet e tokës apo emergjencat dimërore, edhe pse të shkallëve të vogla deri tek të mesme. Nisur nga gjendja ekonomike, infrastruktura, mjetet e pakta të komunikimit, emigrimi masiv, bumi i ndërtimëve si dhe një numër faktorësh që lidhen me shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore, si: Djave, burimeve ujore dhe ndotja e mjesdit, e bëjnë më të prekshme popullsinë dhë ekonominë e saj ndaj këtyre dukurive.



II. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E PLANIT LOKAL TË ZVOGËLIMIT TË RISKUT TË FATKEQËSIVE

Qëllimet kryesore në përgatitejen e dokumentit të "Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë" janë:

1. Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjëne e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
2. Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjëne e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjencë civile.
3. Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme të shtetit me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Nëpërmjet këtij dokumenti krijojen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimi i vendimmarries dhe, nëpërmjet bashkërendimit, arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të emergjencave civile.

"Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë", në thelb, është mjet bashkërendimi, i cili, nëse përdoret në mënyrë korrekte:

- do të shpëtojë jetë njerëzore dhe pasuri,
- do të rritë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese,
- do të sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve dhe të ndihmës shtesë.

"Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë" ka rrjedhë nga detyrimet kushtetuese, ligjore për të garantuar sigurinë publike, realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës të trashëgimisë kulturore, të mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm. Për hartimin e saj jemi mbështetur në: "Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030", Vlerësimin e Rezijeve nga Fatkeqësitë Natyrore në Shqipëri, Ligjin Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", Strategjinë Territoriale dhe Planin e Përgjithshëm Vendor i të bashkisë Pogradec, Ligjet Nr.103/2014 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.348 datë 11.5.2016" Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin, "Strategjia për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planin e veprimit Kosovë, në materiale të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, etj. Qëllimi i këtij plani është të rrisë kapacitetet dhe aftësitë e përgjigjese përmes planifikimit dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, duke pasur si synim kryesor:

- Parapërgatitja/gatishmëria dhe mbrojtja e popullatës
- Parandalimi dhe zbutja e ndikimeve të një situate emergjente në jetën dhe pronën e qytetarëve
- Përgjigjja e integruar dhe efikase, duke përfshirë përdorimin e mijëteve teknologjive të reja
- Rikuperimi i shpejtë dhe zhvillimi i zonës së dëmtuar



III. KUADRI INSTITUCIONAL

Një ndër parimet themelore të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" është 'Subsidiariteti', i cili është 'parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur para sysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkosat e eficiencës e të ekonomisë'. Në këtë kontekst, bazuar në nenin 29, bashkia, si autoritet vendor ka kompetenca të drejtëpërdrejta në fushën e mbrojtjes civile, të cilat i akordohen në vijim edhe nga legjislacioni sektorial.

Ligi 45/2019 "Për mbrojtjen Civile", ka si qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe realizimin e mbrojtjes civile, për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, gjësë së gjallë, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Referuar ligjit, mbrojtja civile ka si mision krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t'u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritisë së një sistemi të integruar dhe eikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj ka sjellë një sërë risish në kuadrin e mbrojtjes civile në Shqipëri si nga pikëpamja institucionale ashtu dhe nga ajo e instrumenteve të përdorura për të arritur qëllimet. Ligji bazuar propozon tre instrumente kryesore, të cilat përdoren si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel vendor dhe përbëhen nga: dokumenti i vlerësimit të riskut dhe cënueshmërisë, strategjia për reduktimin e riskut, si dhe plani i emergjencave civile.

Në nivel kombëtar, si rezultat i ndryshimit ligjor, është themeluar dhe Agjencia Kombëtare e Mbrotjtës Civile. Ky ent, në varësi të Ministrisë së Mbrotjtës, është organi kryesor në nivel kombëtar përsa i përket ushtrimit të detyrate të mbrojtjes civile dhe përgatitjes së instrumenteve përkatëse të sipërcituara në këtë fushë. Prefekti i qarkut ka detyra specifike që i referohen ligjit 45/2019. Këto detyra përfshijnë koordinimin e veprimtarive të organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku, dhe grumbullimin dhe përpunimin e të dhënavë të nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera. Gjithashtu, prefekti siguron koordinimin e shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive, si dhe kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut. Ndërkohë, në nivel vendor, sipas ligjit 45/2019, bashkitë kanë disa detyra të cilat përfshijnë: informimin e publikut dhe komunitetit të rrezikuar dhe organizimin e veprimtarive trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre. Gjithashtu, bashkitë sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë si dhe caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie. Bazuar në ligjin e mësipërm, të gjitha bashkitë janë të detyruara që të krijojnë si pjesë të strukturave të tyre drejtorinë përkatëse të mbrojtjes civile.


Ligi 45/2019 "Për mbrojtjen civile", ka përekatuar qartësisht ndarjen e detyrate që përgjegjësive në çdo nivel, konkretisht përgjejgësitë që ju ngarkohen strukturave vendore janë:



Përgjegjësítë në nivel bashkic

Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, njësi administrative, bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe rifreskojnë periodikisht. Çdo bashki krijon dhe mban një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrate, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjencia.




IV. BASHKIA POGRADEC

I. Pozicioni gjeografik

Bashkia e Pogradecit shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në anë të bregut jugperëndimor të liqenit të Ohrit (695 metra mbi nivelin e detit). Ajo kufizohet në veri me bashkinë e Prrenjasit, në juglindje me bashkinë e Pustecit, në jug me bashkinë e Maliqit dhe në perëndim me bashkinë e Gramshit. Sipërfaqjaj është 595 km² dhe ka 90,726 banorë në përbërjen e territorit të tij.

Pogradeci spikatet për një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, sepse shërben si një urë kontakti duke lidhur shumë qytete mes tyre, por edhe një pikë kalimi për në Republikën e Maqedonisë dhe anasjelltas. Në bashkinë e Pogradecit gjenden dy pikat doganore me Republikën e Maqedonisë ajo e Tushemishtit dhe e Qafë Thanës.



Me implementimin e reformës Administrativo-Territoriale, ndryshimet në sipërfaqe të kufinjve të rinj administrativ të njësive të qeverisjes vendore kanë sjellë shumë ndryshime, të cilat përbëjnë në vetvete vështirësi dhe sfida të reja. Një ndër më të rëndësishmet që është vëzhguar ka të bëjë me nivelin e informacionit për shtrirjen e re territoriale.

Në këtë ndarje te re administrative Bashkia e Pogradecit "përfitoi" ne administrimin e saj 8 Njësi Administrative, Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Velçan.

Pozicioni gjeografik i Bashkisë Pogradec



Njësitë administrative përbërëse

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Pogradec	Qyteti Pogradec
Udenisht	Fshatrat; Udenisht, Mernisht, Çervenokë, Piskupat, Lin, Buqez
Buçimas	Fshatrat; Buçimas, Tushemisht, Peshkopi, Gurra, Geshtenjas, Remenj, Vërdovë, Bahçallëk
Çërrave	Fshatrat; Çërravë, Blacë, Blecas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavc, Kodras, Leshnicë, Lumës, Qershizë
Dardhas	Fshatrat; Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Dordushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stérkonj
Trebinjë	Fshatrat; Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Liengë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgazhan, Malinë, Kalivaç, Pevlon, Dunicë, Guri i Bardhë
Proptisht	Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërrë, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalitare
Velçan	Fshatrat; Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë




2. Demografia dhe zhvillimi ekonomik

Në Bashkinë Pogradec, numri i popullsisë ka ardhur në rritje, nga 38612 banorë në vitin 2010 në 38.630 banorë në vitin 2014 dhe sipas të dhënave të Gjendjes Civile në vitin 2020 popullsia e Pogradecit, duke përfshirë dhe njësietë administrative është 91.702 banorë. Më poshtë po paraqesim popullsinë sipas ndarjeve administrative në Bashkinë Pogradec.

Vlen për tu theksuar se popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes të vazhdueshme migratore drejt qyteteve si Tirana, Durrësi, Elbasani apo edhe emigrimi jashtë vendit.

BASHKIA	Popullsia	% ndaj totalit	Nr. Familje	Gjinia		Grupmoshat			
				Mështaku	Femra	0-14 vjet	15-64 vjet	>65 vjet	
Pogradec	36,842	41%	12,367	18,453	18,389	5,560	27,391	3,891	
Bucimas	17,792	20%	5,259	9,140	8,652	3,397	12,635	1,751	
Cerrave	9,201	10%	2,924	4,797	4,404	1,676	6,518	1,007	
Udenisht	10,920	12%	3,547	5,629	5,291	2,128	7,758	1,013	
Proptisht	6,106	7%	1,941	3,208	2,898	1,276	4,254	537	
Trebinje	3,355	4%	1,178	1,762	1,593	520	2,419	416	
Velean	2,716	3%	917	1,422	1,294	528	1,922	266	
Dardhas	3,794	4%	1,283	1,952	1,842	653	2,747	373	
Total	90,726		29,416	46,363	44,363	15,738	65,644	9,254	
				51%	49%	17%	72%	10%	
Urbane	41%								
Rurale	59%								

Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Janar 2016



Një analizë e kujdeshme e diferençave midis shifrave te Censusit 2011 ille raportimeve të regjistrit te Gjendjes Civile, edhe ne nivel Njesie Administrative nxjerë ne pali edhe dis-



tregues të tjerrë. Sipas tabelës së mëposhtme që paraqet të dy burimet e shifrave të popullsisë, duket se diferençat më të mëdha janë në 3 njësi administrative:

- 1- Qyteti i Pogradecit i cili sipas Censusit të 2011 ka 20.848 banorë ndërkohe që sipas Gjendjes Civile supozohet të ketë 36842 banorë. Kjo diferençë nga Censusi me 15.994 persona, është pothuajse 43% më pak se sa numri i deklaruar në Gjendjen Civile, një shifër kjo e konsiderueshme për nivelet e planifikimit.
- 2- Njesia Administrative e Udënishtit e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë një popullis prej rreth 11.000 banorësh ndërkohe që sipas Censusit të 2011 ka rezultuar pothuajse 45% më pak me 4.785 banorë.
- 3- Njësia Administrative e Dardhasit, e cila sipas Gjendjes Civile duhet të ketë popullsi prej 3794 banorëh, ndërkohe që sipas Censusit ka rreth 42% më pak (2182 banorë).

Duket se këto tre njësi janë prekur më së shumti nga levizjet migratore, ndërkohe që sipas të dhënave, Buçimasi është nga ato njësi qe edhe ka pritur të ardhur nga njësi të tjera duke zbutur kështu diferençen midis të larguarve dhe të ardhurve në atë njësi.



3. Turizmi

Turizmi si një sektor mjaft i rëndësishëm në Bashkinë Pogradec, sidomos viteve të fundit vihet re një rritje e fluksit të turistëve. Nga një anë infrastruktura rrugore, peisazhi i përmirësuar ligenor, kushtet klimaterike të Pogradecit, shërbimi cilësor, produktet bujqësore vendase, tradita e kulinarisë janë burime të rëndësishme për Turizmin e Pogradecit.

Sa i perket turizmit vlen për t'u përmendur fakti që përvèç popullsisë banuese, sidomos në sezonin veror, qyteti pothuajse pesëfishohet në popullsi nga turistët që frekuentojnë hotelet, si dhe banorët jo të përhershëm (ata të cilët kanë shtëpi të dyta në qytet por banojnë në qytete të tjera). Nga viti 2007, ku numri i turistëve në qytetin e Pogradecit për të gjithë vitin ishte 50.200, në vitin 2012, numri i turistëve ka arritur në 150.000.

Nga tabela e mëposhtme, numri i turistëve sipas të dhënave të Bashkisë, është trefishuar nga viti 2007-2012. Në një përiudhë 5-vjeçare është rritja e numrit të turistëve është shume e ndjeshme. Ndërkohë që ky sektor po rritet në mënyrë progresive, nga ana e Bashkisë ende s'ka një plan të qartë, dhe objektiva për ta nxitur ekonominë vendase në shërbim të këtij sektori, dhe në mënyrë që ky turizëm të zhvillohet i organizuar dhe jo në mënyrë spontane. Të dhëna statististikore përfshijnë numrin e turistëve në Pogradec

Figura.4 Numri i turistëve Pogradec, 2012



Zonat e pushimit/atrakcionit më të preferuara nga turistët

Atraksionet më të preferuara

Tabela.3

Përfiti Pogradec	Taxi	Autobus
Burimi i Drilonit	8 min	15 min
Fshati turistik i Tushemishtit	10 min	20 min



Shpella e Najazmes	15 min	25 min
Guri i Kamjes	40 min	1 orë e 10 min
Shpella e Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Manastiri i Shen Marenës	2 orë e 30 min	4 orë
Kanioni i Llëngës	2 orë e 50 min	4 orë e 30 min
Varret e Seleës	1 orë e 30 min	2 orë
Fshati turistik i Linit	20 min	35 min
Mozaikët e Linit	25 min	45 min

Një veçori tjetër e këtij sektori në Pogradec është sezonaliteti. Turizmi lijenor me intensitet më të lartë gjatë dy muajve të verës (korrik, gusht) dhe turizmi malor (dhjetor-mars). Ky turizëm sipas Bashkisë konsiston në turizmin familjar, në hotelet e motelet ekzistuese¹. Kohët e fundit vihet re që ka frekuentim dhe ditor apo në fundjavë.

Megjithatë, Bashkia Pogradec kërkon të promovojojë më shumë opsione për turizmin përveç atij lijenor, atij kodrinoro-malor/agroturizëm, turizëm historiko-kulturor, rekreacioni etj.

Është e rëndësishme që të gjitha këto qëllime dhë objektiva të janë të pasqyruara në plane konkrete dhe sidomos në njohje si fillim të zonës dhe kapaciteteve. Disa prej Njësive Adiministrative të Bashkisë Pogradec mund të janë potencial për atraksione turistike, por nuk kanë ende investimet bazë, si dhe nuk kanë ende vëmendje të mjaftueshme nga pushteti lokal për këto mundësi, dhe njohje te plotë të tyre.

Bashkia Pogradec duke njojur potencialet e Turizmit, dhe efektet ekonomike që sjell ky sektor mund të zbatojë politika fiskale te diferencuara për sektorët që do të stimulojë.



4. Profili i njësive Administrative

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE DARDHAS

Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Niçë është një ndër qendrat e para të banuara të njësisë administrative Dardhas. Fshati i vjetër lidhej me fshatin Llëngë (sot në njësinë administrative Trebinjë), por edhe me qendra të tjera të banuara të Mokrës, Gorës dhe me qytetin e Voskopojës nëpërmjet një rruge të vjetër që ishte degëzim i Via Egnatias. Në këtë fshat ishin zhvilluar mjaft zejtari të e ndryshme, dhe kishte një numër të madh hanesh ku pushonin karvanet e udhëtarëve, dhe prishja e Voskopojës ndikoi keq edhe në ekonominë e këtij fshati, dhe solli largime të banorëve nga fshati drejt zonave të tjera.

Demografia

Njësia administrative Dardhas ka 3566 banorë / 1175 familje (*Burimi: Njësia Administrative Dardhas, 2015*). Dardhasi përbëhet nga 9 fshatra: Dardhas, Osnat, Stopçë, Grunjas, Prenisht, Dërdushë, Lekas, Niçë, Stërkanjë.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Dardhas ditët e sotme janë Bujqësia dhe Blegtoria. Njësia zotëron 2412 Ha tokë bujqësore, e cila ndahet në 2184 Ha tokë arë, 187 Ha pemtore, 41 Ha vreshta, dhe 176.6 Ha gështenja.

Dardhasi njihet për drurët frutorë si: qershitë, dardhat (prej nga ka marrë edhe emrin), lajthitë e kumbullat e egra. Kultivimi i tyre është bërë ndër vite nga banorët e zonës, por shitja e prodhimit në ditët e sotme, has një seri vështirësish, si mungesa e pikave të grumbullimit dhe mungesa e një pike frigoriferike për konservim.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Dardhas janë 22 biznese të vogla të regjistruara, kryesisht shitore, apo lokale-kafene. Ka patur një kërkesë për një pikë grumbullimi frigoriferike (për mollët, dardhat e qershitë) por aplikuesi nuk e ka ndërtuar dot për arsyen ekonomike.

Figura 5. Pamje nga rruga për në fshatin Dardhas



PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE TREBINJË

Gjeneza – historiku i fshatrave

Zona e Mokrës Sipër ka një terren të thyer malor, ku mbizotëron mali i Koçicës, prej të cilit rrjedhin përrrenj të shumtë që bashkohen në rrjedhën e lumit Shkumbin. Pika e lartë e këtij fshati bëri që zona të arrijet t'i shpëtojë disi ndikimit të pushtuesve otomanë. Nga qendrat e para të banuara të kësaj njësie ka qënë fshati Llëngë, pranë të cilit kalonte një degëzim i rruges



Egnatia (e cila bënte lidhjen më fshatin Niçë, e më tej më Voskopojën). Në shek. XVII-XVIII Llëngë pati një zhvillim të madh ekonomik, dhe u kthye në një qendër të rëndësishme zeztarie e tregtie, që rrëth vitit 1750 numëronte rrëth 10000 banorë. Prishja e Voskopojës ndikoi pashmangshmërisht edhe në fatin e Llëngës.

Figura 6. Fshati Trebinjë



Demografia

Njësia administrative Trebinjë ka **3197 banorë / 1097 familje** (Burimi: *Njësia Administrative Trebinjë, 2015*)

Trebinja përbëhet nga 15 fshatra: Çezëm e Madhe, Çezëm e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Pleshisht, Hoshtecë, Zemçë, Trebinjë, Potkozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë.

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Trebinjë janë **Bujqësia (60%)** dhe **Blegtoria (40%)**. Kultura kryesore është gruri.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Trebinjë, që është ndoshta edhe njësia më e varfër e Bashkisë Pogradec, janë rrëth 28 biznese të vogla, kryesisht shitore, lokale - kafencë, një mulli me çekiç dhe një nallban. Biznese të mëdha të regjistruara janë një subjekt me vaska peshku dhe një TV kabllor.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE PROPTISHT

Figura 7. Fshati Slabnijë



Gjeneza – historiku i fshatrave

Territori i njësisë administrative Proptisht përfshin një pjesë të zonës së Mokrës së Poshtme. Mokra e Sipërme me Mokrën e Poshtme kanë disa të përbashkëta por edhe dallime, si në folklor, veshje popullore e në të folur. Varret monumentale të Selcës, të gdhendura në gur, ndodhen në kodrën Gradishtës të Selcës, në pjesën perëndimore të fshatit të sotëm Selcë e Poshtme.



Demografia

Njësia administrative Proptisht ka 6393 banorë / 1938 familje (*Burimi: Njësia Administrative Proptisht, 2015*). Proptishti përbëhet nga 15 fshatra: Proptisht, Homçan, Kriçkovë, Selcë Poshtë, Homezh, Rodokal i Sipërm, Rodokal i Poshtëm, Zall-Torre, Golik, Vërr, Slatinë, Selishtë, Baribardhë, Somotinë, Slabinjë.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Proptisht janë rreth 43 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (shitore, bar -bufë, e ushqimore), dhe 6 biznese të mëdha (2 HEC, 2 Antena televizive, dhe 2 miniera: 1 minierë Hekur- Nike në fshatin Baribardhë, dhe 1 minierë kromi në fshatin Rodokal i Sipërm).

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Proptisht janë Bujqësia (70%) dhe Blegtoria (30%). Kulturat kryesore që kultivoohen janë gruri, misri, tershëra, fasulet, patate, foragjeret e perimet e ndryshme.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE VELÇAN

Figura 8. Fshati Jollë



"qumësht", Shpellë nga "speleo" (shpellë), etj.

Demografia

Njësia administrative Velçan ka 3725 banorë (*Burimi: Njësia Administrative Velçan, 2016*) dhe përbëhet nga 9 fshatra: Velçan, Buzaishë, Laktosh, Senisht, Bishnicë, Losnik, Shpellë, Jollë, Zgallë. Fshati më i madh është Velçani me 1800 banorë, dhe fshati më i vogël e më i largët është Zgalla, në vijim të fshatit Jollë.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Velçan janë rreth 32 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (shitore, bar -bufë, e ushqimore), dhe 1 HEC aktiv në Bishnicë (dhe 2 të tjera në ndërtim e sipër)

Gjeneza – historiku i fshatrave

Velçani është një nga fshatrat e mëdhenj të Mokrës së Poshtme, dhe ndahet në disa lagje. Paria e këtij fshati, historikisht ka dominuar të gjithë zonën e Mokrës

Edhe në këtë zonë ka gjurmë që dëshmojnë për vjetërinë e zonës, psh. toponimet nga koha e pushtimit romak (me origjinë latine), Bishnicë nga "bosco" (pyll), Laktosh nga latinishtja "lactum", që ka kuptimin

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Velçan janë Bujqësia (60%) dhe Blegtoria (40%). Kulturat kryesore që kultivoohen janë gruri, patatet, foragjeret e perimet e ndryshme.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË

Figura 9. Fshati Alarup

Gjeneza – historiku i fshatrave



Territori i njësisë administrative Çërravë përfshin një pjesë të fshatrave të zonës së luginës së Çërravës (Çërrava, Nizhavci, Leshnica), dhe një pjesë të fshatrave të Malit të Thatë (Blacë, Alarup, Bletas).

Demografia

Njësia administrative Çërravë ka 9853 banorë (*Burimi: Njësia Administrative Çërravë, 2015*) dhe përbëhet nga 10 fshatra: Çërravë, Lurnas, Leshnicë, Grabovicë, Nishavec, Blacë, Bletas, Alarup, Kodras, Qershizë. Fshati më i madh është Çërrava me 1902 banorë.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Çërravë janë rreth 83 biznese të vogla, kryesisht të natyrës të shërbimeve (tregti pakice, bar-kafe, TV kabllor, ambulancë e lëvizshme, profesione të lira, 1 sallon bastesh e 1 bilardo), dhe 15 biznese të mëdha (asfaltim/inerte).

Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet të tjera të rëndësishmë ekonomike në Njësinë Administrative Çërravë janë Bujqësia dhe Blegtoria. Veçanërisht në zonën e Çërravës dhe Leshnicës është e zhvilluar pemëtaria e vreshtaria, dhe kulturat më të kultivuara janë: mollët e gështenjat. Mollët kanë vështirësi për t'u shitur pasi nuk ka as treg, as një vendmagazinim frigoriferik të mirëfilltë. Ka vetëm një frigorifer në fshatin Grabovicë, i cili është ndërtuar me investim privat.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE HUDEÑISHT

Gjeneza – historiku i fshatrave



Fshati Lin, nga gjetjet e deritanishme, mendohet të ketë qënë një një vendbanim i lashtë dhe i madh. Mbi kodër janë zbuluar mozaikët e vjetër dhe bazilika bizantine (e ndërtuar rreth shek. VI, në kohën e perandorit Justinian).

Demografia

Njësia administrative Hudenisht ka 7894 banorë (*Burimi: Njësia Administrative Udënisht, 2015*) dhe përbëhet nga 6 fshatra: Mëmëlisht, Çervenakë, Udënisht, Piskupat, Buqezë, Lin. Fshati më i madh është Udënishti me 2712 banorë.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Udënisht janë rreth 30 biznese të mëdha (nga 60 që kanë qënë, para prishjes të ndërtimeve buzë lijenit). Ndër ta veçohen 5 Hotele dhe 6-7 operatorë minierash të licencuar, ndërsa pjesa tjetër janë biznese familjare (kryesisht shitore).

Figura 10. Fshati Lin



Bujqësia, Blegtoria

Aktivitetet kryesore ekonomike në Njësinë Administrative Hudenisht janë Peshkimi dhe Bujqësia. Nga 150 varka të licencuara për të kryer peshkimin e koranit (për të gjithë Bashkinë Pogradec), 100-120 varka i ka Komuna Udënisht.

PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS

Figura.11



Gjeneza – historiku i fshatrave

Fshati Tushemisht, në vendin ku është sot, mendohet të jetë populluar jo më shumë se 200 vjet më parë, nga të ardhur prej fshatrave përreth ose nga zona më të largëta. Vendbanimi i vjetër, mendohet të ketë qënë në një vend më të ngritur (prapa kodrës së Kishës të Shën Pandelimonit). Starova ka qënë qendra administrative për tërë trevën e Pogradecit në kohën e

Perandorisë Osmane, pra edhe fshati më i madh. Vetë emri "Starovë" nga sllavishtja ka kuptimin "i vjetër" (fshat i vjetër).

Demografia



Njësia administrative Buçimas ka 21180 banorë (*Burimi: Njësia Administrative Buçimas, 2015*) dhe përbëhet nga 8 fshatra: Buçimas, Vërdovë, Rëmenj, Gështenjas, Bahçallëk, Gurras, Tushemisht dhe Peshkëpi. Fshati më i madh është Buçimasi me 7500 banorë.

Ekonomia

Në njësinë Administrative Buçimas, aktivitetet kryesore ekonomike janë Bujqësia dhe Blegtoria (70%), të ndryshme (20%) dhe artizanati (10%). Baza e ekonomisë ka qënë ndërtimi, por me bllokimin e lejeve janë krijuar vështirësi të shumta. Në njësinë Buçimas (kryesisht në pjesën breglijenore) ka Hotele dhe restorante, të cilat krijojnë mundësi punësimi për banorët e zonës, dhe të qytetit. Në këtë njësi gjenden atraksione të ndryshme si Parku i Drilon-it, Fshati turistik i Tushemishtit, Mozaiku i Tushemishtit, Pjesa breglijenore, Gatimet tradicionale etj

Bujqësia, Blegtoria

Kulturat kryesore që kultivoohen në njësinë Buçimas janë drithërat, pemëtarja dhe bimët medicinale. Kohë më parë është mbjellë edhe sherebelë, por më pas u shkul, për shkak të rënies së çmimit në treg.

5. Shendetësia

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Pogradec ofrohet nga shërbimi shëndetësor parësor dhe ai spitalor. Shërbimi shëndetësor parësor i specializuar mbulon shërbimin e mjekut të familjes, shërbimin pediatrik, konsultor të nënës dhe fëmijës, kardiologji, krokirurgji, shërbim laboratotik, si dhe shërbim urgjencë mjekësore.

Bashkia Pogradec është dhe njësia që ka mbulimin më të madh me qëndra shëndetësore. Numri i qendrave të kujdesit shëndetësor që gjenden në këtë njësi janë:

- Qendra Spitalore Pogradec
- Materniteti Pogradec
- Poliklinika
- Konsultori i fëmijës (1 ambient)
- Konsultori i gruas (1 ambient)
- Qendër shëndetësore për lagjen 1-2 injeksione (1 ambient)
- Qendër shëndetësore për lagjen 3-4 injeksione (1 ambient)

Njësia administrative Buçimas ka në territorin e saj tetë qendra të kujdesit shëndetësor, praktikisht një për çdo fshat.

Njësia administrative Çerravë ka po të njëjtën mbulim për numër fshatash, 11. Numri total i doktorëve është 3. Këta të fundit mbulojnë territorin sipas ndarjes së mëposhtme:

Çerravë, Leshnicë, Lumas, Qershizë – 1 Doktor

Petrushë, Grabozicë, Nishavec – 1 Doktor



Blacë, Alarup, Bletas – 1 Doktor

Në Çerrave është poliambulanca me 3-4 infermierë dhe 1 doktor, që mbulon dhe Leshnicën, Qershizën dhe Lumasin në ditë të caktuara. Infermieri nuk ka në Lumas, për punë pagese nga Komuna. Kompetencia aktuale e Komunës është përmirësuar, jo përmirësime.

Njësia administrative Trebinjë ka në total 7 qendra shëndetësore, nga të cilat vëçohet ekzistencë e një spitali dhe 6 qendrat e tjera janë funksionale.

Njësia administrative Udënisht ka pesë qendra shëndetësore, të cilat i mbulojnë vetëm 3 doktorë.

Njësia administrative Velçan ka një qendër shëndetësore të madhe.

Njësia administrative Proptisht, në Selishtë dhe Baribardhë nuk ka qendër shëndetësore. Fshatrat e tëra kanë nga një dhomë, por janë funksionale.

Konkluzione:

Si një funksion që pritet të delegohet, qëndrat shëndetësore duhen pasur kujdes të evidentohen, dhe të dihen nevojat e fshatrave vecanërisht për këto qëndra, për ti ardhur në ndihmë nevojave të qytetarëve e vecanërisht gruas dhe fëmijëve në zonat rurale.

Shërbimi shëndetësor ofrohet për çdo individ në Bashkinë Pogradec edhe më gjérë nëpërmjet shërbimit të urgjencës dhe shërbimit spitalor për të gjitha moshat. Urgjencia i përgjigjet çdo lloj thirje për ndihmë nga qytetarët. Autoambulanca shkon në vendngjarje. Ndiha e parë jepet në vendin e ngjarjes, ku ndodhet i sëmuri dhe më pas transportohet për në qëndrën më të afërt të urgjencës së kualifikuar. Lajmërimi i çdo lloj urgjencë bëhet në numrin 127 të telqe është nr. për urgjencën kombëtare e cila e specifikon telefonatën në qëndrën shëndetësore më të afërt dhe në qoftë se gjëndja është e rëndë transportohet me mjete tokësore (ambulancë) ose elikopter për në spitalin e traumës.

Shërbimi shëndetësor i Bashkisë Pogradec disponon:

Ambulanca 6

Laboratore 3

Numur Shtretërish spitalor 145

Personel shëndetësor 224

Në fakt, emergjencat ndaj epidemive shëndetësore duhet që gjithashtu të jenë pjesë e dokumenteve për reduktimin e riskut.

Janë një sërë sfidash sa ligjore, institucionale aq edhe të lidhura me kapacitetet financiare e teknike. Gjithsesi, strategjia do të përfshijë dhe rekomandime përkatëse, bazuar në një analizë të situatës aktuale përsa i përket COVID-19 në bashkinë Pogradec, në mënyrë që më pas të merren masa institucionale përfshirjen e këtij komponenti shumë të rëndësishëm.

6. Zhvillimi urban dhe infrastruktura rrugore

Në këtë seksion do të shqyrtohet sistemi i infrastrukturave rrugore në tërësi, duke marrë në konsideratë klasifikimin e rrjetit rrugor, analizimin e gjendjes ekzistuese, shtrirjen, llojin e transportit, lidhjet infrastrukturore etj.

Bashkia Pogradec eshtë një nyje e rëndësishme në rrjetin kombëtar dhe ndërkombëtar të transportit si pjesë e Korridorit VIII, Rrugës Egnatia dhe Transportit Ujor Ndërkufitar në Liqenin e Ohrit si pjesë e korridorit VIII ai bën pjesë në aksin hekurudhor dhe

rrugor Durres - Vlorë - Rrogozhin - Elbasan-Prenjas-Pogradec.



Territori i bashkisë Pogradec përbëhet nga disa aksa të rëndësishme rrugore kombëtare të cilat e ndihmojnë atë për t'u lidhur me rajonet e tjera fqinje. Në bashkinë Pogradec shtrihet rruga nationale Tirana - Korçë një aks i rëndësishëm që lidh kryeqytetin me rajonin juglindor. Kjo rruge në territorin e bashkisë shtrihet përgjatë vijës ligenore në periferi si dhe futet në brendësi të qytetit. Ky është një aks i rëndësishëm për transportimin e pasagjerëve dhe mallrave. Një aks tjetër i rendësishëm është ai "Qukës - Qafë Plloçë" i cili tashmë ka filluar të ndërtohet dhe që do të bëjë një lidhje më efikase të kryeqytetit me Bashkinë e Pogradecit dhe Korçës. Gjithashtu vlen të përmendet edhe linja hekurdhore Elbasan - Prrenjas - Pogradec e cila pavarësisht se sot është jashtë funksionit është një potencial i madh për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të territorit të bashkisë.

Nga analiza përgjithësuese mund të nxjerim disa tregues domethënës për rrjetin rrugor të Qytetit të Pogradecit duke ju referuar dhe hartave të emërtimit të magjeve, skemave, qarkullimit, apo dhe hartës të klasifikimit të rrjetit rrugor.



Rrjeti rrugor perfaqeson pjesen me vitale dhe me delikate te nje zone urbane, duke e konsideruar si nje organizem te gjalle qe eshte vazhdimisht i "ushqyer" me njerez, mallra, energji, informacion. Rrjeti urban rrugor eshtë i ndare ne tre kategori rrugesh: primare(te pershpëjtimit), sekondare (rrjedhese) dhe te treta (te lagjeve dhe lokale).

Rruget Primare Jane rruget me funksione hyrese dhe dalec nga qyteti dhe ne sherbim te Transportit te kembimit ndermjet territorit urban dhe ekstra urban, si dhe te Transportit transit perkundrejt zonave urbane. Ne kategorinë e rrugeve primare Urbane perfishihen:

Autostradat Urbane – Seksionet e te cilave i kemi rekomanuar per ndertimin e By-Paseve te qytetit te Pogradecit ;


Rruget primare rrjedhese –fuksioni i te cilave eshte garantimi i fluiditetit te zhvendosjes së kembimit te automjeteve edhe rrjetit të qarkullimit brenda qytetit. Ato lejojnë një nivel të lartë të sherbimit të zhvendosjes ne distanca me te medha brenda rrjetit urban. Ne kete kategori rrugesh bejne pjese rruget e shpejta urbane, rruget me shpejtesi te kufizuar urbane, itineraret e rezervuara te mjeteve publike te krijuara ne korsite e rrugeve te rezervuara dhe nga rruge me korsi te rezervuara.

Rruget Sekondare ose Rruget e lokale jane rruge urbane me kapacitet te mesem dhe te larte, me funksionet e meposhteme:

- mbledhjen/shperndarjen e trafikut ndermjet rrugeve primare dhe linjat me kapacitet te ulet te rrjetit
- nen -lidhjet me njesite bashkiake te qytetit

Rruget e lokale me funksion lidhes ndermjet lagjeve fjinje (zhvendosje ne distanca minimale, gjithmone brenda qytetit) ose per zonat urbane me dimensione me te medha, ndermjet pikave ekstreme te lagjeve. Ne kete kategori hyjne, rruget e destituara per sherbimet kryesore urbane te lagjeve.

Rruget e treta jane rruget urbane me kapacitet te ulet me hyrje lokale per ne njesite administrative.



Përsa i përket zhvillimit urban, sistemi urban zë rrëth 3% të të gjithë territorit administrativ të Bashkisë Pogradec, me përqëndrimin më të madh të tij në pjesën breglienore, ku në ndryshim me bashkitë e pjesës të bregut perëndimor të Republikës të Shqipërisë, vetëm rrëth 40% e popullsisë shtrihet në zonat urbane dhe rrëth 60% në zonat rurale. Në këtë drejtim, zhvillimi urban i zonave rurale e ka ndryshuar pak karakterin e tij sipas vendbanimeve të trashëgura ndër vite, ndërsa në zonat urbane është tjetërsuar kryesisht nëpërmjet zhvillimit në lartësi në pjesën breglienore të qytetit të Pogradecit dhe banesave individuale informale në pjesët e tjera të territorit suburban.

Objektivat kryesore strategjike përbajnjë:

- Trajimin e rigjenerimit ekonomik nëpërmjet përcaktimit të politikave ekonomike të përshtatshme për situatën aktuale të Bashkisë Pogradec
- Rizhvillim të sistemit urban dhe ristrukturim të strukturës ekzistuese me vlera historike dhe kulturore për zonën
- Ristrukturim dhe rikualifikim të sipërfaqes urbane të kompaktësuar në zonat rurale. Përmirësim i cilësisë të jetës në strukturën urbane me anë të ndërhyrjeve në infrastrukturën inxhinierike dhe atë të shërbimeve
- Përmirësim i cilësisë të jetës në strukturat urbane nëpërmjet zhvillimit të politikave konkrete në mbështetje të zhvillimit cilësor konform kërkesave bashkëkohore, stimulimit të zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit.
- Rritje të standardeve në shërbime
- Krijimin e parqeve të reja urbane në funksion të aktiviteteve rekreative dhe ndërlidhura me mjedisin natyror dhe ekologjik
- Identifikimin dhe përcaktimin e politikave të zhvillimit të qëndrave lokale dhe komunitare



- Përcaktimin e kritereve bazë për mënyrat e ndërhyrjes në territorit.
- Evidençimin e planeve konkrete të prioritizimit të ndërhyrjeve në infrastrukturë dhe strukturën ekzistuese nëpërmjet identifikimit të projekteve konkrete
- Ngritjen e sistemit të të dhënavët në sferën shumëdimensionale të planifikimit të shërbimeve e cila lejon përditësim të vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve logistike në administratën publike në funksion të këtij shërbimi.



7. Mjedisi dhe përdorimi i tokës.

Veçoritë fizike dhe mjedisore

Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që teritori i bashkisë së Pogradecit të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Rreshjet janë të pakta dhe ato bien në formë bore dhe shiu.

Karakteristikat kryesore të klimës në rajonin e Pogradecit

Nr	KARAKTERISTIKA	TIPI
1	Tipet kryesore të klimës	Mesdhetare kontinentale para malore
2	Vendodhja e stacionit më të afërt metereologjik	Pogradec
3	Rreshjet mesatare vjetore	760 mm
4	Muaji me rreshjet më të dendura	Dhjetori
5	Muaji me rreshje dëbore më të mëdha	Janari
6	Fillimi dhe fundi i shirave të vjeshtës (p.sh herët në shtator, mesi i tectorit, fundi i tectorit)	15 Shtator - 30 Nëntor
7	Fillimi dhe mbarimi i rreshjeve në pranverë	15 Mars - 30 Prill
8	Fillimi dhe përfundimi i rreshjeve te dëborës	5 Dhjetor - 15 Mars
9	Muaji i shkrirjes së plotë të dëbores	Fillim muaji Maj
10	Fillimi dhe përfundimi i periudhës së thatë	Korrik – Shtator
11	Data e ngicës së parë	Pas 10 Nëntorit
12	Data e ngicës së fundit	10 ditësh i parë Prillit
13	Temperatura minimale mesatare afatgjatë, muaji dhe zgjatja	Temp.mes.vjetore 6-12°C Temp.min.vjetore (-10°C) (-15°C)
14	Muajt e tokës së ngrirë (lartësi 50 cm)	Janar-Shkurt deri 20 cm thellësi


Temperatura maksimale gjatë verës variojnë 36-38 gradë, temperatura mesatare mujore luhatet nga 20 gradë deri në 24 gradë. Gjatë dimrit bien dhe reshje dëbore, ku në rajonin tonë e përreth trashësia shkon në mbi 0.5m, ndërsa në veri në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900-1300 mm, dhe më shumë reshje bien në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme deri në muajin Shkurt. Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës rrihet nga erëra të ftohta. Klima e territorit tokës së Pogradecit është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rrëth afersisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët çështë gjatë zemrës, me një minimum prej -17.2°C.

Shpërndarja e reshjeve të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë me thatësirë që mund të zgjatë disa muaj. Si gjysmë e ftohtë e vitit është marrë inkluziv periudha tetor-mars ndërsa ajo e ngrohtë periudha prill-shtator. Nga analiza e reshjeve të dy periudhave vihet re se reshjet e gjysmës së ftohtë të vitit janë më të mëdha se ato të gjysmës së ngrohtë, gjë që tregon karakterin mesdhetar të shpërndarjes së reshjeve në territorin në studim.

Perdorimi i tokes

Analiza e përdorimit të tokës është trajtuar sipas kategorive dhe nënkatgorive bazë të përdorimit të tokës. Pjesa më e madhe e territorit të bashkisë përbëhet nga kategoria e përdorimit natyror dhe atij bujqësor si dhe banim. Në hartën e përdorimit të tokës janë evidentuar kategori përdorimi si hekurdha, infrastruktura rrugore, ujëra, varreza, arsim, industri dhe ekonomi, institucionale, shëndetësi si dhe zona mirerare. Vihet re një përhapje më e madhe e kategorive të arsimit dhe institucioneve në zonën urbane të qytetit të Pogradecit.

Tokë natyrore		
Ujëm	44321 ha	63%
Bujqësi	10918 ha	16%
Toke bujqësore ne zone urbane	12350 ha	
Infrastrukturë	220 ha	17%
Banim	367 ha	
Industri edhe ekonomi	1850 ha	
Arsim - Shëndetësi	100 ha	
Institucionale	11 ha	
	6 ha	3%
Gjithsej (sipër tokësore sëre ujore e bashkisë)	70300 ha	




V. RREZIQET DHE RISKU I FATKEQËSIVE NATYRORE

Territori i bashkisë Pogradec është i rrezikuar nga një sërë fenomenesh natyrore. Ndër më kryesoret mund të përmendet rreziku sismik, rreziku nga përbërjet, gjorreziqet në formën e rrëshqitjeve të tokës dhe rënies së gurreve, rreziqe nga faktorë atmosferikë si blokimi i rrugëve nga bora, rreziqet nga zjarret masive, si dhe rreziqe të cilat vijnë si rezultat i ndryshimeve klimaterike. Për secilin prej tyre më poshtë jepet një përshtakim i shkurtër i fenomenit, zonat më të rrezikuara, ngjarje historike e disa perspektiva në lidhje me rrezikun e mundshëm. Duke qenë se puna përfundimtare është ende ne proces, dhe informacioni shkencor i detajuar dhe me seri kohore është i kufizuar, sa më poshtë është vetëm një fotografim i shpejtë i situatës.

1. Rreziku Sizmik

Në përgjithësi, Shqipëria është një ndër vendet më të rrezikuara nga dukuritë sismike. Pellgu i Mesdheut, ku ndodhet edhe Shqipëria, është pjesa më aktive në kontinentin Evropian. Shumica e tërmeteve të forta ndodhin në 3 breza sismikë të mirëpërcaktuar



Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sismik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vogla ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rralla me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të forta ($M > 7.0$).

Të dhënat historike përfundimtare janë relativisht të mangëta. Rajoni është prekur nga tërmete historike me intensitet deri në 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar, nga tërmete me magnitudë 5. 3 deri 5. 6. Nisur nga kërkosat e kohes, janë ndërtuar edhe harta të shpejtimeve maksimale reference të trojeve. E tillë është edhe harta e paraqitur më poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit "Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri" – PNUD. Nisur nga aktiviteti sismik historik, ndërimi geologjik si dhe nga studimet e lartpermendura, mund të thuhet se rajoni ndodhet në një zonë aktive nga pikëpamja sismike.

si, brezi Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikroplakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje, brezi Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug, dhe brezi tërmotor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore (Sulstarova, Koçaj, & Aliaj, Rajonizimi Sismik i RPS të Shqipërisë, 1980). Sizmicitë i

REPUBLICA
ALBANIA
PACGRADEC

2. Gjoerreziqet


Rrëshqitjet. Janë një fenomen i përhapur në territorin e bashkisë. Në hartën e përhapjes së meziqeve gjeologjike, janë hedhur rreth 88 rrëshqitje të njoitura, por kjo nuk do të thotë se në këtë territor nuk ekzistojnë rrëshqitje të tjera.

Rrëshqitjet e dherave në fshatin Rrëmën, rrëshqitje e tokës në disa banesa në komunën Hudenisht për mos sitemim të ujравe nëntokësore, në fshatin Velçan, Proptisht, Bishnicë, në ndërtimin e autostradës Qukes – Qaf Plloce, ku u rrezikuan tre banesa, për të cilat, për të gjitha rastet është kërkuar Studim Gjeologjik nga Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Rrëshqitja e Pevelan, Trebinjë faktorët kryesorë të ndodhjes së tyre janë ndikues (ndërtimi gjeologjik, struktura, tektonika, erozioni, përbajtja e lartë e ujравe nëntokësore, rreshjet e dendura të shiut, ndërrhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme, etj).

Pogradeci duke qënë një vend i pasur me minrale të ndryshme si hekur, krom, si edhe qymyre, ka pasur një shfrytëzim të shtresave në thellësi dhe kjo përbën një rrezik gjeologjik. Kanë ndodhur dhe rrezikojnë të ndodhin në fushat minerare qymyrgurore, tashmë të myllura të Alarup, Vërdovë, minierat e hekur-nikelit Guri i Kuq, Çervenakë, minierën e kromit Pojskë, etj. Shfrytëzimi i shtresave të qymyrit dhe xherorëve në thellësi, ka krijuar hapësira boshe nëntokë, të cilat rrezikojnë shembjen e materialit të sipërndodhur dhe për pasoje deformimin e sipërfaqes së tokës nga ai real. Këto janë zona tepër të rrezikshme për objektet inxhinierike, sepse shembja ndodh në mënyrë të menjëhershme dhe vertikalish. Për pasoje ndodhin çedime nga disa mm deri në disa metra të cilat mund të rezultojnë katastrofike si për banorët dhe për territorin. Përhapje të madhe ky fenomen ka në zonën kodrinore dhe malore. Në hartë ky sektor paraqitet me ngjyrë të kuqe. Në hartë, pjesë e këtij sektori, janë konturuar sipërfaqet e rrëshqitjeve të ndodhura e të njoitura deri tanë, zonat e shembjeve (subsidiencave) në fushat minerare të shfrytëzuara, si dhe sipërfaqet e zonave nën erozion. Duke patur parasysh dinamikën e shpateve, ky sektor tenton të tritet dhe të fitojë sipërfaqe të reja nga sektori b (*Sektori me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, me ngjyrë të verdhë*). Në këta sektorë parimi i përgjithshëm është se nuk duhet të ndërtohet, por nëse është e nevojshme, atëherë studimi gjeologo – inxhinierik duhet të jetë shumë i thelluar, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogariten mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekombinohen për banorët ashtu edhe për ndërtimet.

Zonimi i territorit mbi bazën e kushteve gjeologo – inxhinierike. Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të janë marë në konsideratë 3-kriteri. Kriteri litologo-gjeologo-inxhinierik. Kriteri i ekspozitimit ndëri rrezikut gjeologjik, Kriteri i morfoligjik.



3. Rreziku nga Bora

Bllokim tē rrugëve nga dëbora në Bashkinë Pogradec, duke qënë një vend malor ndodh tē të gjithë territorin pér periudhë shumë të shkurtër kohore, por më problematike janë dy njësi administrative Velçani dhe Proptishti:

Në Njësinë Administrative Velçan, fshatrat: Buzaish, Bishnicë, Shpellë, Jollë, Zgallë dhe Senisht gjatë dimrit bllokohen nga bora. Në Njësinë Administrative Proptisht problematke janë fshatrat Homezh, Selcë e Poshtme dhe Dëbroyë. Në Njësinë Administrative Trebinjë problem paraqesin fshatrat Dunicë, Hondisht, Selcë e Sipërmë, Hoshteçë, Çezmë e Sipërmë, Çezmë e Poshtme dhe fshati Llëngë. Kjo ka zgjatur nga disa orë deri në disa ditë, pér shkak tē motit tē keq, infrastrukturës e pamundësisë pér tē ndërhyrë, sidomos fshatrat Velçan, Senisht dhe Jollë. Reshjet e dëbores, ngricat, erërat e forta, rreshjet eshiut, etj. kanë sjellë bllokimin e infrastrukturës rrugore, ngrirje tē ujësjellsave, dëmtimë tē linjave tē energjisë elektrike, ej.

Ngricat gjithashtu janë një fenomen që krijon emergjencë në tē gjithë territorin e Bashkisë, ngrica shkaktoi problem në tubacionet e ujësjellsave, pompat e ujit dhe pajisjet e instaluarët në to. Përtej kësaj, ngricat kanë shkaktuar dhe dëme tē mëdha në bimësi, pemtari e blegtori, si dhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor si rezultat i mbylljes së institucioneve shkolllore është më e prekura dhe bllokohet në mënyrë tē vazhdueshme si rezultat i dëborës. Në këtë periudhë është i vështirë kalimi dhe furnizimi me ushqim, apo edhe ofrimi i ndihmës në raste emergjente. Terreni malor ku shtrihet Bashia Pogradec e favorizon bllokimin e rrugëve nga bora dhe nevojiten investime pér rindërtimin e rrugëve dhe tē mirmbajtjes së tyre.

4. Rreziku nga Përbajtjet

Përbajtjet janë vërshimet e ujit që vijnë si rezultat i rritjes së nivelit tē ujit ndodhin pér shkaqe gjeologjike, atmosferike apo njerëzore. Rritja e nivelit tē ujit në shtratin e lumenjve apo tē nivelit tē lijenit duke bërë rrezik pér njerëzit, gjenë e gjallë, banesat apo infrastrukturën.

Përhapje tē madhe ky fenomen ka patur zonën fushore, kodrinore dhe malore.

Përmendim përbajtjet e vitit 2015, ku Pogradeci dhe i gjithë vendi u përfshi në përbajtje dhe dëme tē konsiderueshme në paisje shtëpiake, bazë ushqimore blegtoriale, toka bujqësore dhe subjekte private. Bashkia Pogradec ka ndjekur tē gjitha procedurat pér shlyerjen e detyrimeve tē qytetarëve por ka qënë një dëm financiar i konsiderueshëm i pazgjidhur deri më sot.

Zonat më problematike në Bashkinë Pogradec përsa i përket përbajtjeve janë:

Në njësitë administrative Buçimas, fshatrat Buçimas, Gështenjas, Rrëmënji, Vërdovë dhe Guras,

Në Njësinë Administrative Çërravë fshati Çërravë, Leshnicë, Nizhavec, Bletas dhe Alarup.

Në Njësinë Administrative Dardhas fshati Dardhas, Stropskë, Dërdushë, Prenisht

Në Njësinë Administrative Hudenisht fshatrat; Hudenisht, Mëmëlisht, Piskupat.

Në Njësinë Administrative Trebinjë, fshatrat: Trebinjë, Dunicë, Çezmë, Kalivac, Potkozhan

Në Njësinë Administrative Proptisht, fshatrat: Proptisht, Zalltore, Vëri, Golik, Këriçkova

Në Njësinë Administrative Velçan, fshatrat: Velçan, Bishnicë, Buzaish, Laktosh.




5. Rreziku nga Zjarret

Zjarret, kryesisht në banesa private por edhe në pyje nëpër territorin e bashkisë gjatë verës nga temperaturat e larta, si në Kala, në tarracat e Gështenjasit, në kodrat e qytetit, etj

Përveç pyjeve prodhues, zjarret kanë djegur edhe zona të mbrojtura, në sipërfaqe të konsiderueshme, duke u humbur vlerat dhe rëndësinë që kanë patur. Për sa u përket shkaqeve, në shumicën e rasteve ata nuk kanë qënë natyrorë. Temperaturat e larta vetëm kanë favorizuar përhapjen e tyre. Zjarret, në mënyrë të veçantë ata të 10 vjeçarit të fundit, në shumicën e rasteve, kanë qënë fazë përmbyllëse e prerjeve të paligjshme, për zhdukjen e këtyre gjurmëve, në sipërfaqet e shfrytëzuara me dhe pa kontrata, sepse pikërisht këto sipërfaqe janë djegur prej tyre. Kjo mbetet arsyja kryesore për pjesën më të madhe të rasteve, duke konfirmuar shkakun kryesor të tyre, faktorin njeri. Pasojat janë katastrofike, jo vetëm se është eliminuar tërësisht mundësia e ripërtëritjes, për shkak të djegies së drurëve farorë, por sepse është djegur edhe gjenerata e re, e instaluar, duke pakësuar sipërfaqen pyjore.

Më posht gjendet grafiku referuar situatave emergjente të shkaktuara nga zjarret për periudhen 2016-2020.

Referuar faktorëve të cilët merren në konsideratë për parashikimin e mundur të riskut për periudhen në vazhdimësi situata vlerësohet me risk të lartë.



6. Konkluzione mbi rreziqet

Si konkluzion, mund të shihet që bashkia Pogradec përballet me një shumëlojshmëri rrezikesh që cilat mund të përmblidhen në tabelën e mëposhtme:



Lloji rrezikut	Niveli	Aftësia e Bashkisë	Aftësia e Komunitetit
Sizmëk	I lartë, prek pjesën më të madhe të zonave të urbanizuara dhe me dendësi të lartë banimë	E vogël, mungesa financiare dha kapacitetet për të ndikuar nëpermirësimin e situatës	E vogël
Përmbytje	I lartë, veçanërisht zona fushore rezikor përmbytje	Pastrimi i Kanaleve Dytësore në mënyrë të vazhdhuashme dhe koordinim me nivelin qëndror për pastrimin e kanaleve pafësore	Pastrimi i Kanaleve tretësore. Aftësia e lartë por varat nga sensibilizimi i fsharëve
Rreshqitje Take	Mesataç rezik i lartë veçanërisht pranë Kalasë	Mesatare (kryesisht marje-masat mbrojtëse)	Mesatare (nuk ka mundësi zhvendosje)
Rënies Gjarrësh	I vogël	Mesatare (masa mbrojtëse, por nuk ka aftësi zhvendosje të komunitetit)	E vogël
Blokimi nga Bora	Mesatar	Mesatar (pastrim rugësh ose	Mesatar (rezik historik i përvitshëm, komuniteti vëllorganizohet për të pörballuar blokimin)
Zjarre	Mesatar	Mesatar (prapërgatitje dhe sensibilizim)	I vogël
Ndryshimet Klimatike	I lartë	E vogël	E vogël

7. Rreziqet aktive te evidentuara në territorin e Bashkisë Pogradec

Fatkeqësitë natyrore që godasin dhe rrëzikojnë rrithin e Pogradecit, janë: vërshimet e përenjve, lumenjve, zjarret në banesa, pyje e kullota, tërmetet, bllokimet e rrugëve nga dëbora, erërat, rrëshqitjet e gurëve dhe dherave, epidemite,etj.

Fatkeqësitë natyrore në rrithin e Pogradecit përbëjnë një tressik për jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit.

Problematika per zgjidhje për parandalimin e situatave emergjente:

- Rruja nationale Korçë – Pogradec (kanalet anësore që shkaktojnë përmbytje)
- Evidencimi dhe marja e masave mbi problematikën e rënies së gurëve me qëllim eleminimin e rrezikut të jetës së kalimtarëve dhe dëmtimit të mjeteve që qarkullojnë në rrugën nationale "Unazë", në hyrje të qytetit Pogradec.
- Lumi Vërdovës (zbatimi i projektit të Bashkisë për rehabilitimin e lumbit, me pastrim dhe prishjen e urave)
- Rehabilitimi i Lumit Rrëmenj, në brendësi të fshatit (prishja e ndërtimeve mbi shtetin e lumbit)
- Pastrimi i kanaleve Pogradec- Tushemisht (rruga e lijenit).
- Forcimi i argjinaturës të lumbit Verdove (nga ish karburanti shtetit deri te 1 Mart).



- Evidentimi, përzgjedhja dhe zgjidhja e problemeve që shkaktojnë situata emergjente në të gjitha Njësitë Administrative për shkak të gjëndjes jo të mirë ekonomike
- Problemi i Banesave që rrezikohen nga rrëshqitja e tokës. Për këtë është e nevojshme hartimi i preventivave për dëmet reale që kanë këto banesa mbi bazën e strukturave ekzistuese. Faza e dytë aplikimi pë Lejë Ndërtimi më vonë dërgimi i dokumentacioni në Prefekturë dhe AKMC.
- Përbën rrezik dhe një masiv shkëmbi në kodrën e Çërravës, shkëputja e të cilat rrezikon banorët e një lagje në fshat.
- Lumi i qytetit (Pastrimi dhe rehabilitimi i lumit)
- Ispektimi i banesave të amortizuara në gjithë territorin e bashkisë Pogradec
- Evidentimi i rasteve të pa zgjidhura, të mbartura ndër vite, (Zjarre, rrëshqitje toke, përmbytje), për kompesimin e familjeve dhe përfitimi i ndihmës financiare.
- Përsa i përket rrëshqitjeve, në territorin e Bashkisë Pogradec ka pikë rreziku; Në Njësinë Administrative Velçan ku rrezikohen 25 familje, në Njësinë Administrative Velçan, Proptisht, Hudenisht, Dardhas dhe Buçimas.
- Zjarret në territorin e Bashkisë Pogradec janë në pyje dhe në banesa. Ka pasur zjarre masive në pyje dhe prodhime bujqësore në periudhën verë-vjeshtë. Përgjithësisht më evidente janë problemet e zjarrit në banesa, ku shkaqet kryesore kanë qenë defektet në rrjetin elektrik, dhe pakujdesia. Mbyllja e rrugëve pranë pallatave, ndërtimi i tyre shumë afér njëri-tjetrit, janë disa nga shkaqet që rrezikojnë jetën e banorëve dhe ekonominë e subjekteve të ndryshme shtetërore e private. Gjithashtu kujdes duhet treguar në vazhdimësi për mbrojtjen nga zjarri në subjekte tregtare si pikë karburanti që mund të çojnë në dëmtime te jetës njerëzore. Plotësimi i stacionit zjarrfikës me paisje për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit në raste emergjencash është në shërbim të komunitetit

Nga informacioni i dhene nga PMNZSH po paraqesim në mënyrë tabelare të dhënat e humbjeve.

Statistika nga zjarri i rënë në banesa, pyje, humbje jete, në baza bushqimore e blegtorale, për periudhën 2016-2020;

Viti	Ngjarje	Zjarre në banesa	zjarre në Pyje	Humbje jete	Zjarr bazë ushqimore- blegtorale	në Të ndryshme	Aksidente në automjete
2016	73	36	20	3	-	17	10
2017	153	53	67	1	10	23	-
2018	100	40	23	1	7	30	-
2019	131	46	62	3	-	10	13
2020	155	66	42	2	3	20	15

• Tabela,17




Referuar faktoreve të cilët merren në konsideratë për parashikimin e mundur të riskut për periudhen në vazhdimësi situata vlerësohet me rishkak të lartë.

Treguesit statistikor referuar paraqitjes grafike për periudhën 2015-2020 dëshmojnë një trend në ulje, shkaktuar nga përmbytjet. Në 2015 kemi 1 humbje jete, në 2017 kemi dëmtime të të mbjellave e produkteve bujqësore nga treshjet e dendura, në 2018 kemi një humbje jete, ndërkohë që vitet e fundit nuk ka pasur problem serioze nga treshjet.

Referuar faktoreve të cilët merren në konsideratë për parashikimin e mundur të riskut për periudhen në vazhdimesi situata vlerësohet me rishkak të lartë.

Më poshtë gjendet grafiku i situatave nga tërmetet. Numri i trmeteve deri në vitin 2020

• Figura.21



Referuar paraqitjes grafike për periudhen 2015-2020 përsa u përket fatkeqësive natyrore tërmeteve vihet re një trend në rritje lidhur me ketë dukuri.

Duke marrë në konsideratë studimet e realizuara për parashikimin e mundur të riskut për periudhen në vazhdimësi bashkia Pogradec vlerësohet si një zonë me rishkak të mesëm.

Me 26 Nëntor 2019, Institut Shqiptar i Gjeoshkencës, Ujtit, Energjisë dhe Mjedisit në orën 03:54, regjistroi një tërmet shkatërrues, me një magnitudë 6.3 të shkallës Rihter në një thellësi prej 38 km, i cili goditi vendin. Epiqendra ishte 22 km nga Durrësi dhe 30 km nga Tirana, ku kanë ndodhur shumica e tërmeteve më të mëdha të regjistruar historikisht, në kufirin konvergjent midis Pllakës Euroaziatike dhe Pllakës së Adriatikut. Tërmeti i 26 Nëntorit është përshkruar nga autoritetet kombëtare si më i fortë që ka goditur Shqipërinë në 30 vitet e fundit.

Si rezultat i fatkeqësisë, gjithsej 202.291 njerëz u prekën në vend, 47.263 mënyrë me drejtpërdrejtë dhe 155.029 mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Tërmeti shkaktoi 51 viktima dhe 913 njerëz të plagosur. Gjithashtu, rrith 17.000 njerëz u shpërgulën për shkak të



humbjes së shtëpive të tyre. Në total, punonjësit e ndihmës së parë shpëtuan 48 njerëz nga shtëpitë e shembura. Tërmeti preku 11 bashki: Shijak, Durrës, Krujë në rrethin e Durrësit, Tiranë, Kamzë, Kavajë, Vorë dhe Rrogozhinë në rrethin e Tiranës dhe Kurbin, Mirditë dhe Lezhë në rrethin e Lezhës. Vlerësimi zbulon se efekti i përgjithshëm i fatkeqësisë në 11 bashki arrin në 985.1 milionë EURO.

Në Bashkinë Pogradec sipas statistikave në vite ka lëkundje të vazhdueshme të tërmeteve me magnitudë të ulët të cilat nuk kanë sjellë dëme serioze (shkatërrim baneshash, humbje jete). Në vitin 2019, tërmeti i Nënët e jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë Rrafshin e Ballkanit, por në Bashkinë Pogradec nuk u përfshi në zonat e prekura sizmike më dëmtime të rënda.

Përsa I përket termave financiare të dhënat nga fatkeqësitetë pasqyrojnë një trend në rritje të dëmeve ekonomike. Ndaj për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjen civile buxhetimi ka shkuar në shpenzime për të afroar shërbim dhe mirëmbajtje. Ndaj për periudhën në vazhdim rëndësi të marrin investimet parandaluese, mbrojtëse si dhe rehabilituese nga fatkeqësitetë.

Rrethi i Pogradecit përsa i përket zhvillimit ekonomik dhe social ka shumë sfida për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitetë. Për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, shoqëror dhe mjedisor, rreziku nga fatkeqësitetë natyrore për Pogradecin është i konsiderueshëm për shkak të propabilitetit që mund të prekë popullatën.



VI. REDUKTIMI I RISKUT NGA FATKEQËSITË PËRMES POLITIKAVE E INSTRUMENTEVE SEKTORIALE

Aftësia ripërtëritëse (Resilience) tashmë është kthyer në një koncept drejtues për politikëbërjen e lidhur me zhvillimin hapësinor dhe veçanërisht përsa i përket riskut të fatkeqësive. Koncepti i aftësisë ripërtëritëse ka evoluar në kohë dhe ka përkuizime të ndryshme, por një gjë e cila është konvergjente në të gjitha rastet është aftësia e një vendi, autoriteteteve dhe sistemeve socio-ekologjike për t'u rimëkëmbur pas një krize (Davoudi, 2019). Në këtë sens, koncepti është gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional duke përfshirë jo vetëm rimëkëmbjen inxhinierike në territor por edhe faktorë të shumtë socialë dhe ekologjikë. Aftësia ripërtëritëse dhe reduktimi i riskut të fatkeqësive kanë marrë një vembudje të rëndësishme në nivel global. Kjo gjë vërehet në prioritetet e Kuadrit Sendai, në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara ashtu edhe në Anxhendën e Re Urbane (UN Habitat, 2016) dhe Axhendën Urbane të Bashkimit Evropian (Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016). Të gjitha këto dokumente strategjike globale vendosin një theks të rëndësishëm dhe tek autoritetet vendore duke qënë se impakti më i madh i krizave është gjithmonë në nivel lokal.

Si rrjedhojë, institucionet vendore duhet të janë të përgatitura si nga ana e kapaciteteve njerëzore, financiare e teknike ashtu dhe nga pikëpamja e instrumenteve të cilët përdoren për të qeverisur territorin. Planet e emergjencave civile te deritanishme vendosin një theks të madh të veprimeve tek përgjigjja pas krizave. Nga ana tjeter, nismat për parapërgatitjen ndaj krizave janë të pakta dhe jo të mjaftueshme. Pra vetë logjika e planeve, bazuar në traditën institucionale të përgjigjes ndaj krizave në Shqipëri, shtyn më shumë drejt përgjigjes pas krizës, sesa drejt reduktimit të riskut.

Aktualisht, Bashkia Pogradec është në fazën e miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV). Ky është i vetmi dokument, i cili me hyrjen në fuqi do të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë me reduktimin e riskut. Ndërkohë nuk ekzistojnë dokumente apo plane të tjera sektoriale e ndërsektoriale, të cilat trajtojnë çështje të reduktimit të riskut. PPV e bashkisë Pogradec ka një trajtim të mirë nga pikëpamja e evidentimit të rreziqueve me të cilat përballet territori dhe komunitetit. Veçanërisht çështjet e përblyjeve dhe të tërmëtit janë të trajtuar në hollësi nga pikëpamja historike e ngjarjeve. Por, në krahun tjeter, qasja e PPV-së ndaj riskut dhe politikat për të rritur aftësinë ripërtëritëse janë të kufizuara. Kryesisht, kësaj çështje i jepet zgjidhje nga pikëpamja e projekteve infrastrukturore, ndërkohë që aspekti social dhe ai ekologjik janë më pak të trajtuar. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë risqet e shumta me të cilat përballet Bashkia e Pogradecit ekziston një kontradiktë midis masave për t'u mbrojtur nga përblyja dhe interesave për zhvillim ekonomik e veçanërisht turizmit. Plansifikimi i territorit, shihet si një instrument i shumë i vlefshëm dhe komplementar me strategjinë e reduktimit të riskut për të rritur aftësinë ripërtëritëse të komuniteteve. Si rrjedhojë, nga një vlerësim paraprak, është e nevojshme që PPV-ja e bashkisë Pogradec të rishikohet e plotësohet në disa aspekte që do të përfornojnë e përmirësonin sa më sipër. Këto plotësime mund të konsistonë në krijimin e programeve për përmirësimin e strukturave nga risku sizmit, rishikim të standardeve vendore të zhvillimit, përmirësim të hapësirave publike, programe pyllëzimi në territore të caktuara dhe politika të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

1. Objektivat kryesorë:

- 1.Harmonizimi i zvogëlimit të riskut në politika dhe plane zhvillimore dhe monitorimi.
- 2.Fuqizimi i kapaciteteve përmenaxhimin e rreziqeve.
- 3.Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe nxitja e institucioneve dhe subjekteve përrreziqet.
- 4.Krijimi i komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë.

Përpjekjet përmes zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në rrithin e Pogradecit, sikurse dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë është një problem i cili është përkeqësuar në vitet e fundit përshtakës së ndryshimeve klimaterike, braktisjes së rrithit nga emigrimi dhe migrimi, zhvillimit të vogël të ekonomisë, degradimin e pyjeve, Menaxhimi i pyjeve të gështenjave përlendë drusore, të mjedisit, të shtretërve të lumenjve, përenjve, mos investimeve në infrastrukturën rrugore. Në territorin e Pogradecit vëzohen këto zona të burimeve sismike: Zona e Mokrës së Poshtme dhe Mokrës së Sipërm, në Njësinë Administrative Proptisht e Velçan.

2. Analiza e pikave të forta,dobësive,rreziqeve dhe mundësive

Pikat e forta

- 1.Legislacioni në fuqi përcakton, detyrat, përgjegjësitet dhe mekanizmat e koordinimit.
- 2.Programet e institucioneve Qëndrore përmes Mbrojtjen Civile.
- 3.Ekzistencë e institucioneve, strukturave në nivel qëndror dhe lokal,e subjekteve private, shqatave, organizatave të shoqërisë civile.
- 4.Ekzistencë e pleneve përmes Emergjencat Civile, Vlerësimi i Rreziqeve Natyrore.
- 5.Institucionet arsimore ofrojnë programe lidhur me rreziqet.

Pikat e dobëta

- 1.Mungesa e kapaciteteve në mjete,pajisje.
- 2.Mungesa e sistemit të paralajmërimit të hershëm.
- 3.Rritja e aktiviteteve përmes ndërgjegjësimin e komunitetit.
- 4.Integrimi i njohurive tradicionale në vlerësimin e risqeve ndaj fatkeqësisë.
- 5.Rritja e koordinimit midis institucioneve gjatë menaxhimit të fatkeqësive natyrore.
- 6.Njohuritë dhe praktikat tradicionale nuk janë integruar mjaftueshem ne sistemet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë

Mundësítë

- 1.Krijimi i inventarit historik të fatkeqësive me qëllim hartimin e politikave dhe planeve në vazhdimësi.
- 2.Përfshirja e vlerësimit të riskut në planet zhvillimore.
- 3.Plotësimi i kuadrit ligjor,të ciklit të menaxhimit të emergjencave lidhur ~~me~~ parashkimin, parandalimin, lehtësimin, gadishmërinë, përgjigjen, rimëkëmbjen.
- 4.Zhvillimi dhe koordinimi i sitemit të hershëm të lajmërimit dhe paralajmërimit të popullatës së rreziquar.
- 5.Prezenca e organizatave të ndryshme, paraqet një mundësi të mirë përmes mbështetje së rastit.

Rreziqet

- 1.Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror është një nga indikatorët që fatkeqësitë në rrëthin e Pogradecit të kenë pasoja të konsiderueshme.
- 2.Financimi i pamjaftueshëm për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
- 3.Infrastruktura ndërtimore dhe trajtimi i baseneve të lumenjve,përrrenjve.
- 4.Mekanizmat koordinues,formatet burokratike dhe administrative,ngadalësojnë rrjedhjen e informacionit dhe vendimarrjen.

Bashkia Pogradec do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme jo vetëm për të adresuar problematikën, por duke llogaritur mbështetje të institucioneve dhe strukturave qëndrore të mbrojtjes civile,të bashkëpunimit me organizatat e ndryshme si dhe donatorët.

Bashkëpunimi me Agjensinë Kombëtare të Mbrotjies Civile, si autoriteti përgjegjës për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë,pas përblyjeve të shkaktuara nga rreshjet,sidomos në vitin 2015 e në vazhdim, me objektivin përritjen e qëndrueshmërisë ndaj përblyjeve ,nëpërmjet Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të hershëm

Në kuadrin e bashkëpunimit, bashkia Pogradecit do të mbështesë në vazhdimësi, bashkitë e tjera të qarkut Korçë, në zbatimin e detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrotja civile me qëllim bashkimin e kapaciteteve. Prefektët e qarqeve kanë rolin parësor në koordinimin për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në qark.

Gjithashtu po punohet për bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, e cila jo vetëm do të përditësohet por dhe do shkëmbohen informacione me institucionin e prefektit të qarkut Korçë dhe Agjensinë Kombëtare të Mbrotjies Civile.

Institucioni i bashkisë informon komunitetin e rrezikuar për fatkeqësitë dhe masat për përbalimin e tyre, duke rifreskuar vazhdimisht faqen e saj me ngjarjet dhe efektet e emergjencave që ndodhin në territorin e saj.


Si pjesë e institucioneve dhe strukturave vendore të mbrojtjes civile në rrëth, **Komisioni Vendor I Mbrotjies Civile** në bashkinë Pogradec, duke u bazuar në aktet ligjore është organ për planifikimin, koordinimin, menaxhimin e veprimeve institucionale shtetërore, subjekteve private organizatave vullnetare,për monitorimin, zhvillimin e strategjisë dhe planin e veprimit.

Detyrë në vazhdimësi mbetet organizimi i veprimatrissë trajnuese në fushën e mbrotjies civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre,në fushën e menaxhimit të emergjencave.

Kryqi I kuq, shoqatat e ndryshme do të mbështesin komunitetin duke ndihmuar me reagim ndaj fatkeqësive.



3. Konkluzione mbi Sfidat në Përballimin e Rriskut ndaj fatkeqive



Sic shihet nga paraqitja grafike mundësitë e ndërhyrjes së bashkisë Pogradec në skemën e strategjisë për zvogëlimin e rriskut janë nga poshtë-lart. Bashkia mund të jape ndihmë të parë, mbështetje bazë, organizon personelin e emergjencave, policinë bashkiake, zjarrëfiksen, policinë e rendit, pra është në bazën vendore të strategjisë.

Kështu që sa më të lartë shifra e të ardhurave përmirësim i pajisjeve ekzistuese aq më shumë do të jenë në shërbim të zvogëlimit të riskut në situate e ngjarje fatkeqësie.

4. Punē nē proces

Aktualisht janë duke u kryer mbledhja e të dhënave dytësore, si dhe vizitat në terren për të evidencuar rreziqet. Gjatë këtyre vizitave kryhen dhe intervista me banorë, kryepleq dhe administratorët e njësive administrative.

Deri në momentin e përhapjes së pandemisë COVID-19, janë realizuar kontakte në njësitë administrative Velcan dhe Proptisht.

Në fakt, emergjencat ndaj epidemive shëndetësore duhet që gjithashtu të jenë pjesë e dokumenteve në reduktimin e rizikut.

Janë një sërë sfidash sa ligjore, institucionale aq edhe të lidhura me kapacitetet financiare e teknike.

Pas kryerjes së vizitave në terren dhe intervistave me komunitetin, Intervistat shërbejnë si një instrument i mirë për të përfshirë komunitetin dhe gjithashtu sensibilizuar atë gjatë procesit të hartimit të strategjisë.

5. Plan i vjetor 2021

REALIZIMI I PLANIT STRATEGJIK VITI 2021				
2	PLANI I DREJTORISË SË EMERGJENCAVE CIVILE, STREHIMI DHE OBJEKTEVE NE BASHKEPRONESI			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT	REALIZIMI
Marrja e masave për parandalimin, parapergatitjen përgjigjen ndaj situatave emergjente që mund të krijojnë nga fatkësi natyrore ose nga dora e njeriut, në territorin që administron Bashkia Pogradec.	1,1 Plan – Veprimi për përballimin e emergjencave civile që mund të evidentohen në territorin që përfshin Bashkia Pogradec dhe planeve te gatishmërisë.	Drejtoria e Emergjencave Civile	Dokument kryesor i hartuar dhc miratuar.	Maj 2021
	1,2 Përditësimi i sistemit te lajmerimit te Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative, dhe institucioneve te varësisë		Lista emërore e burimeve njerezore.	Vazhdimesht
	1,3 Ngritura e strukturave të përhershme ose të përkohshme, grupet e verifikimit ne terren te demeve ne rastet emergjente.		Komisionet e emergjencave dhe grupet e verifikimit ne 7 njesite administrative	2
	1,4 Evidencimi dhe përcaktimi i të gjitha zonave me rrezik në territorin që përfshin Bashkia Pogradec.		Koordinatat në hartë.	Në proces
	1,5 Kapacitetet në burime njerëzore e logistike dhe gjendjes aktuale te vendeve për evakuimin e popullatës në rast emergjencë.		Numri dhe vendodhja e ambjenteve në dispozicion dhe nr. i grupeve operative.	
	2,1 Kryerja e raporteve teknike dhe rinovimi i marrëveshjes me Institutin e Ndërtimit me qëllim përcaktimin e saktë të shkaqeve të dëmit		Përcaktimi shkaqeve dhe shkalla e saktimit.	
	2,2 Kryerja e studimeve gjeologjike nga Sherbimi		Përcaktimi shkaqeve	

shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore.	Gjeologic Shqiptar nëpërmjet AKMC	shkalla e dëmtimit.
	Investimeve sipas buxhetit të përcaktuar për vitin 2021 me qëllim parandalimin dhe shmangjen e rrezikut nga fatkeqësi natyrore.	Numri i investimeve të kryera
Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rehabilitimi për të arritur aftësinë ripërtëritëse me qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në të ardhmen.	2,3	6
	3,1 Trajtimi me ndihmë financiare i banorëve të prekur nga fatkeqësi natyrore për mbulimin e dëmeve të shkaktuara.	Numri i dëmshpërblimeve.
	3,2 Mbështetje dhe ndihmën për strehimin e përkohshëm të banorëve të prekur nga fatkeqësia natyrore e tërmetit në shtëpi lëvizëse/kontainer.	Numri I familjeve.
	3,5 Takime dhe konsultime me specialistët e njësive administrative dhe grupe vullnetare.	Njohje me e plotë me procedurën dhe përmirësimin kushteve të shërbimit.
	3,6 Bashkepunime me PMNZSH dhe pregatitje per stimulime rastesh të situatave emergjente	Parapërgatitja për ndërhyrjen në rastet e situatave emergjente.
	3,7 Trajnine.	Rritja e përfomancës.

